



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

AUTORITETI I
MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 934 Prot.

Tirana, me 12.03.2025

INSPEKTORATIT SHTETËROR
I MBIQYRJES SË TREGUT

Nr. 1770 Prot.

Tirana, me 18.04.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MBI LUFTËN KUNDËR PIRATERISË DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË
TRANSMETIMIT

NDËRMJET

Inspektoratit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut (ISHMT), si institucion qendror publik, në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë, që ka për mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në përputhje me legjislacionin e posaçëm të zbatueshëm në secilën nga fushat e inspektimit, përfaqësuar nga Kryeinspektori, Edison KONOMI

dhe

Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), organ i pavarur, i cili rregullon veprimtarinë në fushën e transmetimeve audiovizive lineare, transmetimeve audiovizive jolineare dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryetari, Armela KRASNIQI;

Në zbatim të:

- Ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 20.01.2016 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT".

Bien dakord të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi (më poshtë referuar si marrëveshja).

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është përcaktimi i fushave dhe formave të bashkëpunimit për mbështetjen e ndërsjelltë institucionale gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave ligjore respektive, në kuadër të garantimit, parandalimit dhe ndalimit të cënimit të të drejtave të transmetimit nga ofruesit e shërbimit mediatik, si dhe në drejtim të ndërgjegjësimit në tërësi për respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të në transmetimet audio dhe audiovizive.

Neni 2

Qëllimi

Marrëveshja ka për qëllim rritjen e shkallës së bashkëveprimit ndërinstitucional në fushat me interes të përbashkët për një funksionim sa më efektiv dhe pëmirësimin e veprimtarisë së institucioneve për garantimin e mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në transmetimet audiovizive, sipas përcaktimeve të legjislacionit të fushës

Neni 3

Bashkëpunimi

1. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në çdo rast në përputhje me objektin e kësaj marrëveshjeje, brenda fushës së kompetencave të parashikuara në legjislacionin që rregullon fushat respektive institucionale, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjit.
2. Bashkëveprimi ndërinstitucional do të realizohet në forma dhe drejtime të ndryshme, pavarësisht atyre të përcaktuara shprehimisht në nenet e kësaj marrëveshjeje.
3. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje palët do të komunikojnë në rrugë zyrtare, duke mos përjashtuar edhe format më të shpejta të komunikimit.

Neni 4

Angazhimet e palëve

Në zbatim të kësaj marrëveshjeje palët angazhohen të bashkëpunojnë në drejtim të:

- Ngritjes së një grupi inspektimi të përbashkët, me përfaqësues nga të dy institucionet, sa i përket luftës kundër piraterisë dhe shkeljes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në transmetimet audio dhe audiovizive.
- Koordinimit në marrjen e masave në zbatim të ligjeve organike të palëve dhe përcaktimeve të legjislacionit që rregullon fushën respektive sa i përket luftës kundër piraterisë të kryer nga OSHMA-të që ofrojnë përmbajtje audiovizive në shkelje të të drejtave të transmetimit.
- Shkëmbimit të të dhënave dhe informacioneve në fushat me interes të përbashkët në mënyrë efikase dhe duke shmangur vonesat burokratike.
- Ofrimit të ndërsjelltë të ekspertizës, garantimin dhe mbështetjen operacionale, teknike dhe ligjore në fushat me interes të përbashkët për të dyja palët.
- Organizimit të aktiviteteve dhe tryezave të përbashkëta me fokus rolin që luan secili

nga institucionet në garantimin e të drejtave të transmetimit, si dhe ndërgjegjësimin në tërësi për respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të në transmetimet audio dhe audiovizive.

- Zbatimin e projekteve të përbashkëta me natyrë teknike dhe zhvilluese që kanë për objekt respektimin e të drejtës së transmetimit si pjesë e të drejtës së autorit.

Neni 5

Përdorimi i informacionit dhe ruajtja e konfidencialitetit

1. Secila nga palët e kësaj marrëveshjeje do ta përdorë informacionin e marrë vetëm për rastet e ushtrimit të funksioneve të saj ligjore për qëllimet e përcaktuara rast pas rasti.
2. Veprimet e kryera nga palët nënshkruese sipas kësaj marrëveshjeje dhe në mënyrë të veçantë shkëmbimet e informacioneve, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Çdo palë e kësaj marrëveshjeje duhet të ruajë informacionin që merr nga pala tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Palët nuk kanë të drejtë të vënë në dispozicion të ndonjë pale të tretë informacionin që kanë marrë sipas objektit të kësaj marrëveshjeje, pa marrë më parë miratimin paraprak të palës që jep informacionin.

Neni 6

Takime të përbashkëta mbi ecurinë e marrëveshjes

1. Çdo 6 (gjashtë) muaj titullarët e secilës prej palëve në këtë marrëveshje bashkëpunimi do të zhvillojnë takime për të diskutuar ecurinë e implementimit të saj, me qëllim që të ndërtohet një sferë sa më e sigurt dhe efikase, sa i përket garantimit të zbatimit të ligjit.
2. Me iniciativën e secilës palë, për probleme të caktuara, takimet mund të bëhen në çdo kohë edhe në nivel hierarkik të ndryshëm nga titullarët e institucioneve respektive.

Neni 7

Afati i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën 1 (një) muaj përpara.

Neni 8

Përmirësimet dhe ndryshime

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe shtesa në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
2. Çdo shtesë dhe ndryshim do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e secilës prej palëve, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

Neni 9
Pika e kontaktit

1. Secila prej palëve do të caktojë nga një përfaqësues, në cilësinë e personit të kontaktit për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit në vijim.
2. Palët do të njoftohen reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

Në zbatim të kësaj marreveshjeje, personat e kontaktit do të jenë;
Për ISHMT : **Neritan Frasheri**

Për AMA: **Ervin Celaj**

Neni 10
Dispozita përfundimtare

1. Çdo mosmarrëveshje midis palëve për shkak të moszbatimit të kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje do të zgjidhen me mirëkuptim në rrugë administrative.
2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.
3. Kjo marrëveshje nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) për secilën palë.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë _____.2025.

**AUTORITETI I MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Armela KRASNIQI

KRYETAR

**INSPEKTORATIT SHTETËROR TË
MBIKQYRJES SË TREGUT**

Edison KONOMI

KRYEINSPEKTOR